# DËSHMI ARKIVI

**A-471920**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Brazili ndalon bastet online, shpërthejnë polemikat dhe protestat në vend |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/26/brazili-ndalon-bastet-online-shperthejne-polemikat-dhe-protestat-ne-vend/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 26 shtator 2026, 15:32:06 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 26 shtator 2026, 15:26:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 26 shtator 2026, 15:25:00 UTC → 26 shtator 2026, 15:27:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `e58a20c0573814afd85e283a48505fb2c73a33985fda1deca48df5a21c063a8c` |
| TEKSTI | `0e0200a71cd5ecb11df04f60883d843db713acbefeea811977784deab23ba865` |
| PAMJA | `c86f85666c5b901a95a9a7778cefedc9bbe992a05f103fecabdd2682ff6707f4` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `c8a93a0fd903ca860f8f014283ee65e8398608c1d82f74d2119d3bc12b91c8d4` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `0334a22cab892da6eda5613cc640e69aa8a23a21585bae5896651df887e79535` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/c8a93a0fd903ca860f8f014283ee65e8398608c1d82f74d2119d3bc12b91c8d4`

**PAMJA E FAQES**

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Brazili ndalon bastet online, shpërthejnë polemikat dhe protestat në vend

26/09/2026 17:26




**Ndalimi i basteve online dhe mbyllja e faqeve të lojërave në celularë është një prej kartave që presidenti Lula po luan për të fituar zgjedhjet presidenciale që do të mbahen të dielën e ardhshme.**

Kreu i shtetit brazilian e kishte njoftuar javën e kaluar këtë mase dhe tani e konfirmoi duke paraqitur një dekret që i ndalon bastet dhe tani ky dekret do të shkojë në parlament me këtë të fundit që ka 120 ditë në dispozicion për ta miratuar dhe konvertuar në ligj. Por aplikacionet dhe faqet online të basteve sportive do të mbyllen dhe fshihen që në 6 tetor.

*'Bastet online po shkatërrojnë të ardhurat në familje, po dëmtojnë shëndetin mendor dhe po iu shkaktojnë probleme në shtëpi njerëzve*-pohoi Lula-për këtë arsye morëm vendimin e palëkundur që të bëjmë atë që është e nevojshme. Brazili do të jetë një vend i lirë nga ky fenomen'.

Por kjo masë nuk u prit aspak mirë nga kompanitë e basteve që protestuan dhe bënë të ditur se do të apelojnë te Gjykata Supreme. Sipas disa vlerësimeve të bëra rezulton se pas këtij dekreti do të mbyllen 15 mijë vende pune në sektorin IT. Por nuk janë vetëm kompanitë e basteve që janë kundër një vendimi të tyre, edhe klubet e futbollit që sigurojnë të ardhura të konsiderueshme nga reklamat pët kompani të tilla e kundërshtojnë presidentin Lula pasi sipas tyre, kjo masë do të shkruajë vdekjen e futbollit.

Vetëm në Serinë A të kampionati brazilian, 14 skuadra nga 20 kanë si sponsor kryesor një operator të basteve. Në 2025, rreth 34% e të ardhurave të klubeve kryesore braziliane vinte nga faqet e basteve për një total prej rreth 170 milionë eurosh. Në ditët e kaluara Lula iu kundërpërgjigj klubeve duke iu kujtura se në të kaluarën kur nuk ekzistonin bastet online futbolli brazilian fitontë shumë më shumë sesa sot. *'Sao Paulo ka qenë 3 herë kampion bote pa baste, Santosi 2 herë. Edhe Gremio, Flamengo dhe Internacional. Edhe Corinthiansi im 2 herë. Edhe kombëtarja jonë ka fituar 5 tituj botërorë kur nuk ekzistonin këto platforma; historia se eliminimi i basteve sportive do të zhdukë futbollin brazilian është një budallallëk'*-përsërit vazhdimisht Lula.

Por ky dekret rrezikon të vërë në krizë edhe llogaritë publike, duke qenë se ky treg, sipas të dhënave zyrtare, bën që të qarkullojnë rreth 5 miliardë euro në muaj. Por në një sondazh të kryer kohët e fundit nga AtlasIntel tregon se Lula ka shumë për të fituar nga kjo ofensivë kundër basteve onlinë; 86.7% e brazilianëve i konsiderojnë bastet të dëmshme dhe 63.2% nënvizojnë se bastet sjellin vetëm humbje.

**Top Channel**


## SPORT • KRYESORE



Analiza/ Endi Tufa: Sonte nuk luajnë vetëm 11-të, sonte luajmë të gjithë



Surpriza e Maranit para Bjellorusisë, 4 lojtarë kuqezi mbeten jashtë...



Frikë për ish futbollistin e Juventusit, operohet me urgjencë në mushkëri, është në terapi intensive



La pas Skelën, Bogdanin e Salihin, zbuloni sulmuesin që dominon historinë e rrjetave ndaj bjellorusëve




Kuqezinjtë nisin misionin e ri në Nations League, të gjitha emocionet live dhe ekskluzivisht në DigitAlb

## ME TË LEXUARAT

Fusha kthehet në ring! Lukaku bën gjestin e turpshëm ndaj italianëve, Donnarumma humb toruan dhe vërsulet drejt tij

'Gjërat nuk janë mirë, besoj se do të kthehet në shtëpi'/ Zidane e parandjeu, Federata Franceze



Top News-Foltoret e Ripërtëritjes në Vlorë dhe Elbasan/Berisha: Orteku i opozitës po rritet çdo ditë



Top News – 'Vlora Hyseni po u jep reston'/Berisha: Po i kthehet bashkëpunëtorëve që e tradhtuan



Top Channel/ Zjarr në kuzhinën e hotelit në Gjirokastër, si u shmang një incident më i madh



**© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.**

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.